

L I G J
Nr.8253, datë 30.10.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7651, DATË 21.12.1992 "PËR FESTAT ZYRTARE"
NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7770, DATË 7.12.1993, NR.7780, DATË 22.12.1993 DHE
NR.8065, DATË 8.2.1996

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7651, datë 21.12.1992 "Për festat zyrtare", ndryshuar me ligjet nr.7770, datë 7.12.1993, nr.7780, datë 22.12.1993 dhe nr.8065, datë 8.2.1996 në nenin 1, gërma "c" ndryshohet si vijon:

"c) 28 Nëntori dita e Flamurit dhe e Pavarësisë është ditë e festës kombëtare".

Pas gërmës "c" shtohet gërma c/1 me këtë përmbajtje:

"29 Nëntori dita e Çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesi nazifashistë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin e tij nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.1954, datë 3.11.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.